



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.854/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Kenar Berisha, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të sigurimit “N...” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit S.S avokat nga Prishtina, ndaj kundërshtarit të sigurimit “T...” Sh.a, me seli në Mirovicë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit F.H, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.nr.789/21 e dates;17.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën; 30.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e propozuesit të sigurimit “N...” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, dhe **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.nr.789/21 e datës 17.01.2022.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin ankimor IV.EK.nr.789/21 e dates;17.01.2022, ka vendosur si në vijim;

“Refuzohet në tërësi si e pa bazuar propozimi për caktimin e masës së sigurisë së propozuesit të masës sigurimit-paditësit “N...” Sh.p.k, me seli në Prishtinë ndaj kundërshtarit të sigurimit-të paditurës “T...”sh.a me seli në Mitrovicë, me të cilën kanë kërkuar caktimin e masës së sigurimit për të drejtat tjera respektivisht ndalimit të palës kundërshatre që t’i kryejë aktivitetet e caktuara,për pengim të dëmtimit të propozuesit,si dhe të ndalohen të gjitha veprimet e personave fizik dhe juridik të palës kundërshtare për dhënjen me qira të pronës një palë tjetër apo veprimet për largimin e propozuesit nga prona,si dhe të obligohet pala kundërshtare të respektoj ligjet në fuqi dhe licencat e dhëna nga KPMM deri sat ë merret një vendim gjyqësor për padinë e propozuesit që do ta ngritë Brenda afatit tridhjetë (30) ditor në Gjykatën Kompetente,si dhe të lejohet propozuesi që të zhvillojë aktivitetet pa pengesë deri sa të merret një vendim gjyqësor për padinë e propozuesit që do ta ngritë Brenda afatit tridhjetë (30) ditor në Gjykatën Kompetente”.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë propozuesi i masës së sigurimit, (pa cekur bazat ankimore), me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar të hudhet,dhe të obligohet pala kundërshtare të respektojë ligjet në fuqi dhe licencat e

dhëna nga KPMM deri sa të merret një vendim gjyqësor për padinë e propozuesit, si dhe ti lejohet propozuesit që të zhvillohet aktivitetet pa pengesë deri sa të merret një vendim gjyqësor për padinë e propozuesit që do ta ngritë Brenda afatit tridhjetë ditor në gjykatën kompetente.

Kundërpropozuesi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë edhe pse e ka pranuar të njejtën me datën 01.02.2022.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesja e sigurimit “N...” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurisë, duke kërkuar që të aprovohet propozimi për masën e sigurisë sipas nenit 296, neni 297 paragrafi 1 pika a), neni 301 pika a dhe d dhe neni 304 të LPK-së, që ti ndalohet kundërshtarit të sigurimit që t'i kryejë aktivitetet e caktuara, për pengim të dëmtimit të propozuesit, ti ndalohen të gjitha veprimet e personave fizik dhe juridik të palës kundërshtare për dhënjen me qira të pronës një palë tjetër apo veprimet për largimin e propozuesit nga prona si dhe të obligohet kundërshtari i sigurimit të respektoj ligjet në fuqi dhe licencat e dhëna nga KPMM deri sa të merret një vendim gjyqësor për padinë e propozuesit.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ka mbajtur seancën dëgjimore dhe ndërgjyqësit i kanë paraqitur pretendimet e tyre sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe pas përfundimit të seancës gjyqësore, ka marr aktvendimin e ankimuar me arsyetim se nuk janë përmbush kushtet në mënyrë kumulative sipas dispozitës së nenit 297 par.1 pika a dhe b të LPK-së, për shqiptimin e masës së sigurisë paragjykohet drejtëpërsëdrejti edhe çështja kryesore.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Dhomës së Shkallës së Dytë e mori këtë vlerësim juridik për arsye se sipas nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se; *“Masa e sigurimit mund të caktohet; a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehejen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen e ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen kushtet ligjore sipas të cilave propozuesi i sigurimit duhet ta bëjë të besushme ekzistimin e kërkesës si dhe ta bëjë të besushme faktin se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështëronte dukshëm realizimin e kërkesës së propozuesve e që në rastin konkret asnjëri nga kushtet ligjore nuk janë plotësuar. Për më tepër propozuesi me propozim ka kërkuar që t'i ndalohet kundërshtarit të sigurimit që t'i kryejë aktivitetet e caktuara, për pengim të dëmtimit të propozuesit, si dhe të ndalohen të gjitha veprimet e personave fizik dhe juridik të palës kundërshtarë për dhënjën me qira të pronës një palë tjetër apo veprimet për largimin e propozuesit nga prona, si dhe të obligohet pala kundërshtarë të respektoj ligjet në fuqi dhe licencat e dhëna nga KPMM deri sa të merret një vendim gjyqësor.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezultojnë se propozuesi i sigurimit në këtë fazë të procedurës, nuk ka ofruar prova bindëse lidhur me besueshmërinë e kërkesës së tyre, e me të cilat do të vërtetoheshin pretendimet lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, ngase aneks kontrata mbi qiranë ka qenë e vazhduar nga data 01.01.2020 deri me datën 28.02.2020, dhe pas kësaj date nuk ka pas tentim për vazhdimin e kësaj kontrate. Kështu nga kontrata bazë dhe aneks kontrata vërtetohet fakti se në mes palëve (paditësit dhe të paditurës) nuk ekziston më shfrytëzimi i objektit kontraktues me qira. Andaj, duke pas parasysh se në mes të palëve nuk ekziston kontrata mbi dhënie me qira atëherë nuk ka edhe bazë juridike për shqyrtimin e masës së sigurisë sepse qiramarrja si veprim juridik në mes të palëve ka përfunduar.

Po ashtu në rastin konkret nuk plotësohet as kushti i dytë ligjor për caktimin e masës së sigurimit sepse propozuesi nuk ka ofruar provë se kundërshtarit të sigurimit do të mund të pamundësojë apo vështërojë dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshjehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë dhe ka gjetur se propozimi është i pabazuar, ka mbështetje ligjore si dhe janë dhënë arsyet e justifikueshme të bazuara në shkresat e lëndës, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Dhoma e Shkallës së Dytë i vlerësoj pretendimet ankimore të propozuesit të sigurimit por gjeti se të njëjtat nuk përbëjnë arsye që kanë mbështetje ligjore, e për të cilat duhet prishur aktvendimi i gjykatës së parë.

Prandaj bazuar në të lartëcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, sepse e njëjta me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se nuk janë përmbushur konditat ligjore të parpara me dispozitën e nenit 297.1 nën a) dhe b) të LPK-së, për caktimin e masës së sigurisë.

Nga të cekurat më lartë e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË,

Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.854/22, data 30.08.2022

Kryetarja e kolegjit-Gjyqtarja
Franciska Zhitija Ymeri